



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

Nr. 27 / 8, datë 30 / 10 /2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “BELSHI SOLAR PARK”, BASHKIA BELSH
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “VERBUND GREEN POWER
ALBANIA” sh.p.k.,
ME NUIS/NIPT: M21423032T”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një parku fotovoltaiik në Bashkinë Belsh, i cili synon të instalojë një kapacitet gjenerues të paneleve fotovoltaike prej 100 MWp në fazën finale të instalimit, kapacitet i cili do të arrihet përmes instalimit të 185,184 moduleve.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) Euro.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 89.62 ha, në ZK 2237, Bashkia Belsh, sipërfaqe e cila figuron në pronësi shtetërore dhe që përbëhet nga dy pasuri: pasuria Nr.152/2 me sipërfaqe 73.25 ha dhe pasuria nr. 210/2 me sipërfaqe 16.37 ha.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Belshi Solar Park”, Bashkia Belsh, me subjekt investues shoqërinë “Verbund Green Power Albania”

shpk, me NUIS/NIPT: M21423032T, në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.

2. Sipërfaqja në të cilën parashikohet të zhvillohet projekti prek në zonën buferike të një monumenti natyror dhe referuar Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” në një monument natyror zbatohet shkalla e mbrojtjes e njëjtë me rezervën strikte, duke mos lejuar kryerjen e asnjë aktiviteti njerëzor që sjell dëmim të ekosistemit.
Projekti i propozuar bie ndesh gjithashtu me parashikimet e Ligjit Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, i ndryshuar, pasi kategoria e bonitetit të parcelave në të cilat synohet të zhvillohet projekti i investimit nuk lejon ndërmarrjen e veprimtarisë së kërkuar nga subjekti.
3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Belsh.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA